<p>dokumentacionin mbështetës dhe të dhënat në bazë të të dhënave nuk përputhen (janë të përziera me personin tjetër), dhe nuk kanë mbështetje ligjore.</p> <p>1.3. Rastet në fjalë në paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni i dërgohen komisioneve për shqyrtim në ARC.</p>	<p>supporting documents and records in database do not match (are mixed with another person), and have no legal support.</p> <p>1.3. The cases of the paragraph 1.1 and 1.2 of this Article shall be sent to the review commissions at ARC.</p>	<p>se podržaju a dokumentacija i zapisa u bazi podataka se ne slažu (miješaju s drugom osobom), i nemaju pravnu podršku.</p> <p>1.3. Navedeni slučajevi u paragrafima 1.1 i 1.2. ovog člana dostavlja se komisiji za razmatranje ACR.</p>
<p align="center">Neni 24 Invalidimi dhe shkatërrimi i pasaportave</p>	<p align="center">Article 24 Invalidation and destruction of passports</p>	<p align="center">Član 24 Poništenje i uništavanje pasoša</p>
<p>1. Me rastin e ndërrimit të pasaportës së Republikës së Kosovës me pasaportë biometrike të Republikës së Kosovës, aplikuesi duhet të dorëzoj pasaportën në momentin e aplikimit, të cilën zyrtari konsullor e invalidon, duke e shpuar në dy kopertinat e forta dhe faqen e personalizimit me pajisjen përkatëse dhe ia kthen aplikuesit.</p> <p>2. Në rast se aplikuesi nuk e pranon pasaportën e invaliduar, atëherë zyrtari konsullor e shkatërron përmes pajisjes përkatëse.</p> <p>3. Invalidimi i pasaportës së dëmtuar, për ripërtëritjen e të dhënave dhe ndërrim të të dhënave, bëhet nga zyrtari konsullor duke ruajtur një kopje të saj.</p> <p>4. Pasaportat të cilat dëmtohen gjatë personalizimit (laminimi i dobët, gabim teknik) nga DPD, duhet të shkatërrohen nga komisioni i themeluar me vendim të MPB-së.</p>	<p>1. When changing the passport of the Republic of Kosovo with the biometric passport of the Republic of Kosovo, the applicant must submit the passport at the time of application, which will be invalidated by the consular officer and perforated in two of its hard bound covers and personalization page by appropriate device and gives back to the applicant.</p> <p>2. If the applicant does not accept invalidated passport, then the consular officer destroys it by appropriate device.</p> <p>3. Invalidation of damaged passport, for renewal of data and data change, is made by the consular officer while keeping a copy of it.</p> <p>4. Passports which are damaged during personalization (weak lamination, technical error) by the DPD must be destroyed by the commission established by decision of the MIA.</p>	<p>1. U slučaju promjene pasoša Republike Kosovo sa biometrijskim pasošom Republike Kosovo, podnosilac zahtjeva mora dostaviti pasoš u vrijeme apliciranja, koju konzularni službenik je poništi, bušiču je u dve korice i prvu stranu personalnih podataka sa odgovarajućom opremom i vrati je aplikantu.</p> <p>2. Ako podnosilac zahtjeva ne prihvati poništeni pasoš, onda konzularni službenik je uništi putom dotične aparature.</p> <p>3. Poništenje oštećenih pasoša, obnavljanje podataka i promjene podataka koju konzularni službenik čuva jednu kopiju.</p> <p>4. Pasoš koji su oštećeni tokom personalizacije (slabo kaširanje, tehnička greška) od OPD, moraju biti uništeni od strane komisije osnovana odlukom MUP-a.</p>

5. Perjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, bëjnë rastet kur pala për arsye objektive kërkon që invalidimi i pasaportës të bëhet më rastin e pranimit të pasaportës së re.

Neni 25

Procedura e lëshimit dhe afatet e lëshimit të dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimet, pasaportat dhe patentë shoferët)

1. Zyrtari i autorizuar nga MPJ bën tërheqjen e dokumenteve të identifikimit të personalizuar dhe të klasifikuara sipas posteve konsullore nga DPD/MPB.

2. DCK i dërgon Postit Konsullor dokumentet e identifikimit të personalizuar përmes postës diplomatike ose korrierit diplomatik.

3. Afati për personalizimin e dokumenteve të identifikimit nga ana e Departamentit për Personalizimin e Dokumenteve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

4. Afati për lëshimin e dokumenteve të identifikimit nga posti konsullor është jo më vonë 30 (tridhjetë) ditë, në përjashtim të problemeve teknike apo kur rastet janë në shqyrtim në komision.

5. Me rastin e pranimit të postës diplomatike me dokumente të identifikimit, zyrtari konsullor bën numërimin dhe evidentimin e tyre në programin për pranim të dokumenteve.

5. Exceptionally from the paragraph 1 of this Article, are the cases when the party, because of objective reasons, requires invalidation of the passport when receiving new passport.

Article 25

The procedure of issuance and terms of the issuance of identification documents (identity cards, passports and driving licenses)

1. Official authorized by the MFA withdraws from the DPD/MIA personalized and classified identification documents according to the consular posts.

2. DCI sends to the consular post personalized identification documents through diplomatic mail or diplomatic courier.

3. The deadline for personalization of identification documents by the Department of Personalization of Documents is 15 (fifteen) days.

4. The deadline for the issuance of identification documents by the consular post is not later than 30 (thirty) days, with the exception of technical problems or when cases are being reviewed at the commission.

5. By receiving diplomatic mail with identification documents, the consular officer performs counting and enters them in the program of receiving documents. In this case,

5. Izuzet od stava 1 ovog člana uraditi kada stranka je iz objektivnih razloga zahtijeva poništavanje pasoša da se uradi tokom prijema novog pasoša.

Član 25

Procedura izdavanja i rok izdavanja ličnih dokumenata (lične karte, pasoše i vozačke dozvole)

1. Službenik ovlašten od MIP-a čini privlačenje identifikacionih dokumenata personificirani i klasifikovani prema konzularnim predstavništvu OPD / MUP-a.

2. OCK šalje konzularnom predstavnštvu dokument identifikacije personificirane putem diplomatske pošte ili diplomatskog kurira.

3. Rok za personalizaciju identifikacijskih dokumenata u Odeljenju za Personalizirane Dokumentacije je 15 (petnaest) dana.

4. Rok za izdavanje ličnih dokumenata od konzularnih predstavništva najkasnije u roku od 30 (trideset) dana, s izuzetkom tehničkih problema ili kada u slučajevima se razmatraju od komisije

5. Po primanju diplomatske pošte s identifikacionim dokumentom, konzularni službenik izračuna i evidentira u programu za prijem dokumenata. U ovom slučaju, kandidati

<p>Me këtë rast aplikuesit nga listat përkatëse të evidentuara në program njoftohen me sms/email/telefon, së dokumenti i tyre është i gatshëm për tërheqje.</p>	<p>applicants from the respective lists, identified in the program, are notified by sms/email/phone, that their document is ready to be withdrawn.</p>	<p>sa liste evidentirani u programu obaviješteni putem sms / e-mail / telefon, njihovi dokument je spreman za njihovo povlačenje.</p>
<p>6. Para se dokumentet e identifikimit t'i dorëzohen aplikuesit, zyrtari konsullor duhet të bëj regjistrimin e dokumentit përkatës në program të "lëshimit".</p>	<p>6. Before handing over the identification documents to the applicant, the consular officer shall register the relevant document in the respective program of "issue".</p>	<p>6. Prije identifikaciona dokumenta podnosiocu zahtjeva, konzularni službenik će uzrokovati registraciju relevantan dokument u programu "Release".</p>
<p>Neni 26 Pranimi i kërkesave për fitimin e shtetësisë</p>	<p>Article 26 Receive of applications for acquisition of citizenship</p>	<p>Član 26 Prihvaaanje zahtjeva za sticanje državljanstva</p>
<p>1. Postet konsullore pranojnë kërkesat e qytetarëve për fitim të shtetësisë sipas Udhëzimit Administrativ për procedurat e aplikim, fitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. Consular posts receive applications of citizens to get citizenship according to the Administrative Instruction on procedures of application, acquisition of citizenship of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1. Konzularna predstaništva prihvaaaju zahtjeve gradana da dobiju državljanstvo pod Administrativno Uputstvo o procedurama aplikacije, steći državljanstvo Republike Kosovo.</p>
<p>2. Paraqitja e kërkesës për fitim të shtetësisë duhet të bëhet personalisht, duke paraqitur dokumentet si në vijim:</p>	<p>2. The submission of application for citizenship must be made in person, by submitting the following documents:</p>	<p>2. Zahtjev za dobijanje državljanstva treba uraditi personalno, podnošenjem sljedećih dokumenta:</p>
<p>2.1. Certifikatën e lindjes së aplikuesit;</p>	<p>2.1. The applicant's birth certificate;</p>	<p>2.1. Certifikat iz matične knjige rođenih aplikanta;</p>
<p>2.2. Ekstraktin e lindjes, të prindit më shtetësi të Kosovës;</p>	<p>2.2. Extract of birth, of the parent with Kosovo citizenship;</p>	<p>2.2. Ekstrakt rođenja, roditelja sa državljanstvom na Kosovu;</p>
<p>2.3. Pajtimi i fëmijës më i vjetër së 14 (katëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;</p>	<p>2.3. Consent of the child older than 14 (fourteen) up to 18 (eighteen) years of age;</p>	<p>2.3. Usaglašavanje dijete starijeg od 14 (četnaest) do 18 (osamnaest) godina;</p>
<p>2.4. Pajtimi me shkrim i prindit që nuk posedon shtetësinë e Kosovës, i noterizuar;</p>	<p>2.4. Written consent of the parent who does not possess the citizenship of Kosovo, notarized;</p>	<p>2.4. Pismenu saglasnost roditelja koji ne poseduje državljanstvo Kosova,</p>

<p>2.5. Certifikatën e martesës të Kosovës;</p> <p>2.6 Dëshmitë të lejes së qëndrimit të vlefshëm në Republikën e Kosovës për 5 (pesë) vjet;</p> <p>2.7. Certifikata e martesës që dëshmon së paku 3 (tre) vite të lidhjes së martesës dhe së paku 1 (një) vit banim të ligjshëm në RKS para se të bëhet parashtrimi i kërkesës;</p> <p>2.8. Dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Zyra Komunale e Tatimit të Kosovës mbi përmbushjen e obligimeve tatimore;</p> <p>2.9. Dokument që dëshmon kushte adekuate të banimit respektivisht mjete të mjaftueshme materiale për të siguruar jetesën e vetë dhe personave për të cilët është përgjegjës;</p> <p>2.10. Dëshmi që nuk është nën hetime dhe që nuk është i/e dënuar për vepra penale e lëshuat nga Gjykata kompetente në RKS dhe organi kompetent i shtetit të huaj prej nga vjen parashtruesi i kërkesës respektivisht ku ai/ajo kanë pasur vendbanimin në 6 (gjashtë) muajt e fundit;</p> <p>2.11. Deklaratën e betimit me shkrim që e pranon rendin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës;</p>	<p>2.5. Kosovo marriage certificate;</p> <p>2.6. Evidence of valid residence permit in the Republic of Kosovo for 5 (five) years;</p> <p>2.7. Marriage certificate that shows at least 3 (three) years of marriage and at least 1 (one) year legally residing in the RKS before submission of the application;</p> <p>2.8. Evidence from the Tax Administration of Kosovo and Municipal Tax Office of Kosovo on the fulfillment of tax obligations;</p> <p>2.9. Document that proves adequate housing conditions, respectively sufficient material funds to ensure his and other person's livelihood for whom is responsible;</p> <p>2.10. Evidence that is not under investigation and is not convicted for criminal offenses issued by the competent court in the RKS and the competent authority of a foreign country from where the applicant comes, respectively where he/she resided during 6 (six) recent months;</p> <p>2.11. Written sworn statement that recognizes the constitutional and legal order of the Republic of Kosovo;</p>	<p>noterizovano;</p> <p>2.5. Certifikat vençani Kosova;</p> <p>2.6. Dokaz o važeću dozvolu boravka u Republici Kosovo za 5 (pet) godina;</p> <p>2.7. Vjenčani list koji dokazuje najmanje 3 (tri) godine braka, i najmanje 1 (jedna) godina koji zakonito borave u RKS prije podnošenja zahtjeva;</p> <p>2.8. Dokazi iz Porezne Uprave Kosova i Poreska Uprava Opštine Kosovu o ispunjavanju poreskih obaveza;</p> <p>2.9. Dokaz o adekvatnih uslovima stanovanja, odnosno dovoljno sredstava kako bi se osigurala sredstva za život ljudi i osoba za koje je odgovoran;</p> <p>2.10. Dokaz da nije pod istragom, da nije on/ona osuđen za zločine dato od nadležnog suda i nadležnog organa RKS stranoj zemlji dolazi od podnositelja prijave odnosno u kojoj on / ona boravio u 6 (šest) posljednjih mjeseci;</p> <p>2.11. Pismenu izjavu pod zakletvom da priznaje ustavno-pravni poredak Republike Kosovo;</p>
---	---	--

<p>2.12. Dëshmi të pagesës së taksës konsullore për këtë shërbim.</p> <p>3. Të gjitha kërkesat e parapara në nenin 26 të këtij Udhëzimi dorëzohen nga postet konsullore përmes DÇK tek institucioni kompetent në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Pas pranimit të vendimit lidhur me fitimin e shtetësisë, postet konsullore njoftojnë aplikuesit të cilët për tërheqjen e vendimit duhet të paraqesin dëshminë e pagesës së taksës konsullore së parapare për këtë shërbim.</p> <p>5. Postet konsullore janë të obliguara që t'i raportojnë pranimin/dorëzimin e vendimit nga ana e aplikuesit përmes DÇK në institucionin kompetent në Republikën e Kosovës.</p>	<p>2.12. Evidence of payment of the consular fee for this service.</p> <p>3. All applications set forth in Article 26 of this Instruction are submitted by the consular posts through DCI to the competent institution in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. Upon receipt of the decision concerning the acquisition of citizenship, consular posts notify applicants that in order to withdraw the decision they must submit evidence of payment of the consular fee prescribed for this service.</p> <p>5. Consular posts are obliged to report the handover of the decision by the applicant through DCI to the competent institution in the Republic of Kosovo.</p>	<p>2.12. Dokaz o uplati konzularne takse za ovu uslugu.</p> <p>3. Svi zahtjevi iz člana 26. ovog Upustva podnosi se od konzularnog predstavništva kroz OKP na nadležne institucije u Republici Kosovo.</p> <p>4. Nakon prijema odluke u vezi sa sticanjem državljanstva, konzularna predstavništva obavijestiti kandidate da je odluka o povlačenju mora dostaviti dokaz o uplati propisane konzularne takse za ovu uslugu.</p> <p>5. Konzularna predstavništva su dužna da prijave prijem / isporuke odlukom zahtjeva putem OKP nadležne institucije u Republici Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27</p> <p style="text-align: center;">Pranimi i kërkesës për humbjen e shtetësisë së Kosovës me lirim</p> <p>1. Postet konsullore pranojnë kërkesat e qytetarëve për humbje të shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim të parapara me Udhëzimet Administrative për procedurat e humbjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim.</p> <p>2 Paraqitja e kërkesës për humbje të shtetësisë me lirim duhet të bëhet personalisht, duke paraqitur dokumentet si në vijim:</p> <p>2.1. Dëshminë për posedimin e shtetësisë të</p>	<p style="text-align: center;">Article 27</p> <p style="text-align: center;">Receive of application on deprivation of citizenship of Kosovo, by release</p> <p>1. Consular posts receive citizen applications for deprivation of citizenship of the Republic of Kosovo by release, in accordance with the Administrative Instructions on procedures of deprivation of citizenship of the Republic of Kosovo by release.</p> <p>2. Submission of application for deprivation of citizenship by release must be made in person, by submitting the following documents:</p> <p>2.1. Evidence of possession of citizenship</p>	<p style="text-align: center;">Član 27</p> <p style="text-align: center;">Prihvaćanje zahtjeva za gubljenje državljanstva Kosova sa slobodom</p> <p>1. Konzularna predstavništva \prihvate zahtjeve građana za gubitak državljanstva Republike Kosova s olakšanjem predviđenog sa Administrativnom Upustvom o procedurama za gubitak državljanstva Republike Kosovo sa slobodom.</p> <p>2. Zahtjev za olakšanje gubitka državljanstva treba uraditi personalno , podnošenjem sljedećih dokumenata:</p> <p>2.1. Dokaz o posjedovanju državljanstva</p>

<p>ndonjë shteti tjetër apo garancionin se kjo shtetësi do t'i jepet;</p> <p>2.2. Ekstraktin/Certifikatën e lindjes;</p> <p>2.3. Kopjen e dokumentit të identifikimit valid;</p> <p>2.4. Dëshmi për vendbanimin në shtetin e huaj;</p> <p>2.5. Dëshmi për vendbanimin e fundit në Republikën e Kosovës;</p> <p>2.6. Dëshminë nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Zyra Komunale për Tatimin në Pronë (mbi përmbushjen e obligimeve tatimore);</p> <p>2.7. Dëshminë nga Qendra komunale për pune sociale;</p> <p>2.8. Dëshmi të lëshuar nga policia dhe gjykata e Republikës së Kosovës, se aplikuesi nuk është nën hetime apo i dënuar për vepra penale;</p> <p>2.9. Dëshmi të lëshuar nga organi kompetent i shtetit të huaj, shtetas i të cilit është parashtruesi i kërkesës apo shtetin në të cilin aplikuesi ka pasur vendbanimin e fundit, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj, se aplikuesi nuk është nën hetime apo i/e dënuar për vepra penale;</p> <p>2.10. Dëshmi nën betim që shtetasi që</p>	<p>of another country or guarantee that this citizenship will be granted;</p> <p>2.2. Extract/certificate of birth;</p> <p>2.3. A copy of a valid identification document;</p> <p>2.4. Evidence of residence in a foreign country;</p> <p>2.5. Evidence of latest residence in the Republic of Kosovo;</p> <p>2.6. Evidence from Tax Administration of Kosovo and the Municipal Office of Tax Property (on fulfillment of tax obligations);</p> <p>2.7. Evidence from Municipal Center of Social Labor;</p> <p>2.8. Evidence issued by the police and court of the Republic of Kosovo that the applicant is not under investigation or convicted for criminal offenses;</p> <p>2.9. Evidence issued by the competent authority of a foreign country, whose citizen is the applicant, or the country in which the applicant has resided last, not older than six (6) months, that the applicant is not under investigation or convicted for criminal offenses;</p> <p>2.10. Affidavit that citizen seeking release, is not civil servant (judge, public</p>	<p>druge države ili garantirati da će biti odobrena državljanstvo;</p> <p>2.2. Ekstrakt/Certifikat rodenja ;</p> <p>2.3. Kopija važećih dokumente za identifikaciju;</p> <p>2.4. Dokaz o prebivalištu u stranoj zemlji;</p> <p>2.5. Dokaz o zadnjem prebivalištu u Republici Kosovo;</p> <p>2.6. Dokazi iz Poreske Uprave i Opštinske Kancelarije za Porez na Imovinu (o ispunjavanju poreskih obaveza);</p> <p>2.7. Dokazi iz opštinskog Centra za socijalni rad;</p> <p>2.8. Potvrda policije i suda u Republici Kosovo, da podnosilac zahtjeva nije pod istragom ili osuđivan za krivična dela;</p> <p>2.9. Potvrda nadležnog organa strane države, čiji je državljanin je prijavljen ili zemlji u kojoj je podnosilac prošle boravio, ne stariji od šest mjeseci 6, da podnosilac zahtjeva nije pod istragom i / ili osuđeni za krivična djela;</p> <p>2.10. Izjavu da građanin traži olakšanje, a da nije državni službenik (sudije, javni</p>
--	--	---

<p>kërkon lirim, nuk është nëpunës civil (gjykatës, prokuror publik, pjesëtar i policisë etj.); dhe</p> <p>2.11. Dëshmi të pagesës së taksës konsullore për këtë shërbim/ kërkesë.</p> <p>3. Të gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi nga paragrafi 2.1, 2.4 dhe 2.9 të këtij neni, duhet të jenë të përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Të gjitha kërkesat e parapara në këtë Nen, dorëzohen nga postet konsullore përmes DÇK në institucionin kompetent në Republikën e Kosovës.</p> <p>5. Pas pranimit të vendimit për lirim nga shtetësia e Republikës së Kosovës, postet konsullore njoftojnë aplikuesit të cilët për tërheqjen e vendimit, duhet të paraqesin dëshminë e pagesës së taksës konsullore të paraparë për këtë shërbim, të drejtën e ankesës dhe detyrimet (dorëzimin e dokumenteve identifikuese të Republikës së Kosovës.</p>	<p>prosecutor, police officer etc.); and,</p> <p>2.11. Evidence of payment of the consular fee for this service/application.</p> <p>3. All documents submitted as evidence under the paragraph 2.1, 2.4 and 2.9 of this Article, must be translated into one of the official languages in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. All applications set forth in this Article are submitted by the consular posts through DCI to the competent institution in the Republic of Kosovo.</p> <p>5. Upon receipt of the decision concerning the release from the citizenship of the Republic of Kosovo, consular posts notify applicants that in order to withdraw the decision, they must submit evidence of payment of the consular fee prescribed for this service, the right of appeal and obligations (handover of the identification documents of the Republic of Kosovo.</p>	<p>tužilac, policijski službenik i sl); i</p> <p>2.11. Dokaz o uplati konzularne takse za ovu uslugu/aplikaciju.</p> <p>3. Svi dokumenti nudeni kao dokaz iz stava 2.1, 2.4 i 2.9 ovog članka, moraju biti prevedeni na jedan od službenih jezika na Kosovu.</p> <p>4. Svi zahtjevi ovog člana, isporučuje konzularna kroz OKP nadležne institucije u Republici Kosovo.</p> <p>5. Nakon prijema odluke o puštanju državljanstva Republike Kosova, konzularna predstavništva obavijestiti kandidate koji za povlačenje odluke, mora dostaviti dokaz o uplati propisane konzularne takse za ovu uslugu, pravo na žalbu i obaveza (podnošenje identifikacionih dokumenata Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 28 Aplikimi për lirim e shtetësisë së Republikës së Kosovës nga shtetësia i/e të miturve</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Application on release of citizenship of the Republic of Kosovo from citizenship of the minors</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Aplikacija za oslobađanje državljanstva Republike Kosova sa državljanstva za maloljetnike</p>
<p>1. Paraqitja e kërkesës për humbje të shtetësisë me lirim për të miturit parashtrohet përmes njërit nga prindërit, në të njëjtën kërkesë të parashtruar nga prindërit apo prindi</p>	<p>1. The application for deprivation of citizenship by release for minors is submitted by one of the parents, in the same application submitted by parents or parent at the consular</p>	<p>1. Prijava zahteva za gubitak državljanstva za maloljetnike sa oslobodjenjem zahtevase od jednog od roditelja, u istom zahtevu podnosilac jedan od roditelja ili oba roditelja u</p>

<p>në postin konsullor të Republikës së Kosovës duke paraqitur dokumentet si në vijim:</p> <p>1.1. Dëshminë për posedimin e shtetësisë të ndonjë shteti tjetër apo garancionin se kjo shtetësi do t'i jepet;</p> <p>1.2. Ekstraktin e lindjes;</p> <p>1.3. Kopjen e dokumentit të identifikimit të të miturit, nëse e posedon;</p> <p>1.4. Ekstraktet e lindjeve të prindërve;</p> <p>1.5. Dëshmi për vendbanimin në shtetin e huaj ku banon;</p> <p>1.6. Dëshmi për vendbanimin e fundit të prindërve në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.7. Kopjet e dokumenteve të identifikimit të dy prindërve;</p> <p>1.8. Pajtimi i të miturit më i vjetër se 14 (katëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjet;</p> <p>1.9. Deklaratën e pajtimit me shkrim nga të dy prindërit e vërtetuar tek noteri;</p> <p>1.10 Dëshmi të pagesës së taksës konsullore për këtë shërbim/ kërkesë.</p> <p>2. Në përjashtim të pikës 1.4, 1.6, 1.7 dhe 2.9 të këtij neni, në rast se përkujdesjen ndaj</p>	<p>post of the Republic of Kosovo by submitting the following documents:</p> <p>1.1. Evidence of possession of citizenship of another country or guarantee that this citizenship will be granted;</p> <p>1.2. Extract of birth;</p> <p>1.3. A copy of the identity document of the minor, if in possession;</p> <p>1.4. Extracts of birth of parents;</p> <p>1.5. Evidence of residence in the foreign country where is residing;</p> <p>1.6. Evidence of the latest residence of parents in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.7. Copies of identity documents of both parents;</p> <p>1.8. Consent of the minor older than 14 (fourteen) up to 18 (eighteen) years of age;</p> <p>1.9. Written statement consent from both parents certified by the notary;</p> <p>1.10 Evidence of payment of the consular fee for this service/application.</p> <p>2. With the exception of point 1.4, 1.6, 1.7 and 2.9 of this Article, in case that one of the</p>	<p>konzularnom predstavništvu Republike Kosovo podnošenjem sljedećim dokumentima:</p> <p>1.1. Dokaz o posjedovanju državljanstva druge države ili garanciju da će biti odobreno državljanstvo;</p> <p>1.2. Ekstrakt rođenja;</p> <p>1.3. Kopija dokumenta identiteta maloljetnika, ako je poseduje;</p> <p>1.4. Ekstrakti rođenja roditelja;</p> <p>1.5. Dokaz o prebivalištu u stranoj zemlji prebivališta;</p> <p>1.6. Dokaze o zadnjem roditeljskog prebivališta u Republici Kosovo;</p> <p>1.7. Kopije ličnih dokumenata oba roditelja;</p> <p>1.8. Pomirenje maloljetnika starijeg od 14 (četnaest) do 18 (osamnaest) godina;</p> <p>1.9. Izjava o pristanku napismeno od oba roditelja uverena kod notara;</p> <p>1.10. Dokaz o uplati konzularne takse za ovu uslugu / zahtjev.</p> <p>2. U izuzetu ove tačke 1.4, 1.6, 1.7 i 2.9 ovog članka, ako starateljstvo za maloletno dete ima</p>
---	--	---

<p>fëmijës se mitur e ka njëri prind, dëshmitë duhet të plotësohen vetëm nga njëri prind që është në përkujdesje të fëmijës së mitur. Në këtë rast kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe dëshmia me të cilën vërtetohet se prindit në fjalë i është besuar përkujdesja ndaj fëmijës.</p> <p>3. Në rast se të paktën njëri prind i fëmijës identifikohet para se fëmija të ketë mbushur moshën 7 (shtatë) vjeçare dhe prindi në fjalë nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, me kërkesë të prindit fëmija e humb shtetësinë e Republikës së Kosovës, me kusht që me humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës fëmija të mos mbetet pa shtetësi.</p> <p>4. Të gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi nga paragrafi 1.1, 1.5 dhe 1.9 të këtij neni, duhet të jenë të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.</p> <p>5. Zyrtari konsullor kryen të gjitha veprimet e parapara në Nenin 27 pika 4 dhe 5.</p>	<p>parents is in the custody of the minor child, the evidence should be filled only by one of the parent who is in the custody of the minor child. In this case, the evidence which proves that the custody for the child is entrusted to the said parent should be attached to the application.</p> <p>3. If at least one parent of the child is identified before the child reaches 7 (seven) years of age and the said parent is not citizen of the Republic of Kosovo, at the request of the parent, the child loses citizenship of the Republic of Kosovo, provided that by losing the citizenship of the Republic of Kosovo, the child is not left without citizenship.</p> <p>4. All documents submitted as evidence under the paragraph 1.1, 1.5 and 1.9 of this Article, must be translated into one of the official languages in the Republic of Kosovo.</p> <p>5. The consular officer performs all the actions foreseen in Article 27 point 4 and 5.</p>	<p>jedan roditelj, dokazi moraju biti popunjena samo od jednog roditelja koji se stara maloljetnim djetetom. U tom slučaju treba priložiti dokaz da se dokazalo da navedenom roditelju je povjerena briga za dijete.</p> <p>3. Ako je identifikovana barem jedan od roditelja djeteta prije nego što dijete napuni 7 (sedam) godina i roditelj nije državljanin Republike Kosovo, na zahtjev roditelja djeteta gubi državljanstvo Republike Kosova, pod uslovom da je gubitak državljanstva Republike Kosovo dijete ne postane bez državljanstva.</p> <p>4. Svi dokumenti koje se nude kao dokaz iz stava 1.1, 1.5 i 1.9 ovog člana treba biti prevedeni na jedan od službenih jezika na Kosovu.</p> <p>5. Konzularni službenik obavlja sve akcije predviđene u članu 27 stav 4 i 5.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Aplikim për viza D (leje qëndrim)</p> <p>1. Postet Konsullore në bazë të Ligjit për të Huaj 04/L-219, Udhëzimit Administrativ që rregullon procedurën e lëshimit të vizave për të huajt në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore dhe Udhëzimit administrativ për procedurën e lëshimit të leje qëndrimit për të huaj nga MPB, për shtetasit e shteteve ndaj të cilave Republika e Kosovës aplikon regjim</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Application for D visa (residence permit)</p> <p>1. Consular posts based on the Law on Foreigners 04/L-219, Administrative Instruction which regulates the procedure of issuing visas to foreigners at the diplomatic missions and consular posts and Administrative Instruction on procedure of issuing residence permit for foreigners by the MIA for citizens of the countries to which the Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Viza D (dozvolu boravka)</p> <p>1. Konzularna predstavništva u skladu sa Zakonom za strance 04 / L-219, Administrativno Uputstvo uređuje postupak izdavanja viza strancima u diplomatskim i konzularnim i Administrativnim Uputstvom za postupak izdavanja boravišnu dozvolu za strance od strane MUP-a za građane zemalje na koje Republika Kosovo primjenjuje vizni</p>

vizash, pranojnë kërkesa për vizë D. Kërkesat për viza D (leje qëndrim) mund të parashtohet vetëm në Poste Konsullore ku ofrohen shërbimet për viza.

2. Viza hyrëse (D) :

2.1. Viza hyrëse (D) lëshohet atëherë kur i huaji e pranon konfirmimin nga MPB për marrjen e leje qëndrimit (afatshkurtër, të përkohshëm dhe të përhershëm) në Republikën e Kosovës në pajtim me udhëzimin për procedurën e lëshimit të leje qëndrimit për të huaj.

2.2. Viza hyrëse (D) lëshohet për një hyrje me afat vlefshmërie prej 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Neni 30

Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile

1. Zyrtarët konsullor, të cilët janë të certifikuar sipas Ligjit të Gjendjes Civile të Republikës së Kosovës janë të autorizuar të bëjnë regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

2. Pranimi i kërkesave për këto shërbime bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të MPB-së për procedurat e përgjithshme të regjistrimit të faktit të lindjes, martesës dhe vdekjes dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij

applies visa regime, receive applications for D visa. Applications for D visa (residence permit) may only be submitted at consular posts where visa services are provided.

2. Entry visa (D) :

2.1. Entry visa (D) is issued when a foreigner receives confirmation from the MIA for obtaining a residence permit (short-term, temporary and permanent) of the Republic of Kosovo in accordance with the guidance on the procedure for issuing residence permit for foreigners.

2.2. Entry visa (D) is issued for single entry valid for 90 (ninety) days.

Article 30

Registration of civil status facts

1. Consular officials certified according to the Law on Civil Status of the Republic of Kosovo are authorized to register births, marriages and deaths.

2. Receiving applications for these services are made according the Administrative Instruction of the MIA on general procedures of registration of fact of birth, marriage and death and other applicable legal provisions.

3. Exceptionally from the paragraph 1 and 2 of

režim. prihvati zahtjeve za vize D. viza D (boravišna dozvola) može se dostaviti samo u Konzularne Predstavništva gde se nude usluge za vize.

2. Ulazna vizu (D):

2.1. Ulazna viza (D) se izdaje kada stranac dobije potvrdu iz MUP-a za dobijanje boravišne dozvole (kratkoročne, privremene i trajne) u Republici Kosovo, u skladu sa smjernicama o postupku za izdavanje boravišnih dozvola za strance.

2.2. Ulazna viza (D) se izdaje se za jedan ulaz sa rokom od 90 (devedeset) dana.

Član 30

Upis činjenica civilnog statusa

1. Konzularni službenici, koji su certificirani prema Zakona o Gradanskom Pravu Republike Kosovo su ovlašteni da evidentiraju rodene, vjenčane i umrlie.

2. Prihvatanje zahteva za ove usluge se vrši prema Administrativnim Uputstvu MUP opšte procedure za registraciju činjenice rođenja, braka i smrti i druge zakonske odredbe na snazi.

3. Izuzet od stava 1 i 2 ovog člana u

neni në rastet kur zyrtarët konsullor nuk janë të certifikuar, atëherë kërkesat për regjistrimin e lindjes, martesës dhe vdekjes dërgohen përmes DCK në ARC.

Neni 31 Regjistrimi i lindjeve

1. Postet konsullore janë të autorizuar të pranojnë kërkesat për regjistrimin e fakteve të lindjes (deri në moshën 14-vjeçare) me pranimin e fletëkërkesës, sipas shtojcës III për regjistrimin e lindjes së fëmijës në librin amëz të lindjeve në Kosovë.

2. Regjistrimi i lindjes përmes deklaramit konform neneve 34 dhe 35 të Ligjit për Gjendjen Civile dhe lindja mund të deklarohet, nga njëri prind, personi madhor i familjes, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, përfaqësues të nënës më prokurë të posaçme dhe personat e autorizuar konform paragrafit 2 të nenit 34 të Ligjit për Gjendjen Civile.

3. Dokumentet e nevojshme për deklaramin/regjistrimin e lindjes:

3.1. Kopja e dokumentit të vlefshëm të identifikimit të personit që e deklaroi lindjen;

3.2. Kopja e certifikatës së raportit mjekësor nga institucioni shëndetësor;

this Article, in cases where consular officers are not certified, then the applications for the registration of birth, marriage and death are sent through DCI to ARC.

Article 31 Registration of births

1. Consular posts are authorized to receive applications for registration of facts of births (up to 14 years of age) upon receipt of the application form, according to the Appendix III on registration of child's birth in the civil register of births in Kosovo.

2. Registration of birth through the declaration in accordance with Articles 34 and 35 of the Law on Civil Status whereas the birth may be declared, by one of the parents, adult person of the family, legal representative or guardian, mother's representative by special attorney and authorized persons in accordance with the paragraph 2 of Article 34 of the Law on Civil Status.

3. Documents required for the declaration/registration of birth:

3.1 .A copy of valid identification document of the person who declares the birth;

3.2 .A copy of the certificate of the medical report from the medical institution;

slučajevima gde konzularnih službenika nije certifikovan, a zatim zahtjev za registraciju rođenja, braka i smrti posalju se preko ACR u OCK.

Član 31 Registracija rođenja

1. Konzularna predstavništva su ovlaštčeni da prihvate prijave za upis činjenice o rođenju (do 14 godina) nakon prijema zahtjeva obrazac, u skladu sa aneksom III registrirati rođenje djeteta u matičnu knjigu rođenih na Kosovu.

2. Registracija rođenja kroz deklaraciju u skladu sa članovima 34. i 35. Zakona o Civilnom Statusu i rođenje može se proglasiti, od jednog roditelja, odraslog člana porodice, zakonskog zastupnika ili staratelja, predstavnik majka advokata i ovlaštenih lica u skladu sa stavom 2. člana 34 Zakona Civilnog Statusa.

3. Potrebna dokumenta za deklaraciju / registracija rođenja:

3.1. Kopiju važećeg identifikacionog dokumenta osobe koja izjavljuje rođenje;

3.2. Kopija potvrde medicinskog izvještaja iz medicinskog instituta;

<p>3.3. Certifikata e martesës së prindërve nëse kanë lidhur martesë, nëse prindërit nuk janë të kurorëzuar, kërkohet të plotësohet procesverbali mbi pranimin e atësisë (shtojca IV);</p> <p>3.4. Në rast se nuk dihet babai i fëmijës, regjistrimi bëhet në bazë të dhënave të nënës;</p> <p>3.5. Dëshminë për pagesën e taksës konsullore për këtë shërbim.</p> <p>4. Kur fëmija është i lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës nga prindërit të cilët janë shtetas të Kosovës:</p> <p>4.1. Kopjen e certifikatës ndërkombëtare të lindjes së fëmijës që ka të shënuar të dy prindërit;</p> <p>4.2. Ekstraktet e lindjes së prindërve;</p> <p>4.3. Kopjet e dokumenteve të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim) të dy prindërve;</p> <p>4.4. Prezencën e njërit prind;</p> <p>4.5. Dëshminë për pagesën e taksës konsullore për këtë shërbim.</p> <p>5. Kur fëmija është i lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës nga njëri prind shtetas i Kosovës, dhe prindi tjetër shtetas i huaj ose</p>	<p>3.3 .Parents marriage certificate, if they are crowned, if the parents are not crowned, it is required to complete a report on acceptance of paternity (Annex IV);</p> <p>3.4 .In case when father of the child is not known, the registration is made on the basis of mother's data;</p> <p>3.5 .Evidence of payment of the consular fee for this service.</p> <p>4. When a child is born outside the territory of the Republic of Kosovo, from the parents who are citizens of Kosovo is required:</p> <p>4.1. A copy of international birth certificate of the child where the names of both parents are written;</p> <p>4.2. Parents birth extracts;</p> <p>4.3. Copies of identity documents (passport or identity card) of both parents;</p> <p>4.4. The presence of one of the parents;</p> <p>4.5. Evidence of payment of the consular fee for this service.</p> <p>5. When a child is born outside of territory of the Republic of Kosovo, from one parent citizen of Kosovo, and the other parent foreign</p>	<p>3.3. Vjençani list roditelja ako su venčani, ako roditelji nisu u braku, potrebno je popuniti zapisnik o prijemu očinstva (aneks IV);</p> <p>3.4. U slučaju da se ne zna otac djeteta, na osnovu podataka na popis postaje majka;</p> <p>3.5. Dokaz o uplati konzularne takse za ovu uslugu.</p> <p>4. Kada je dijete rođeno van teritorije Republike Kosova od roditelja koji su državljani Kosova:</p> <p>4.1. Kopija certifikata međunarodne rođenja djeteta koja je navedela oba roditelja;</p> <p>4.2. Ekstrakt rođenja roditelja;</p> <p>4.3. Kopije ličnih dokumenata (pasoš ili lične karte) oba roditelja;</p> <p>4.4. Prisustvo jednog roditelja;</p> <p>4.5. Dokaz o uplati konzularne takse za ovu uslugu.</p> <p>5. Kada je dijete rođeno van teritorije Kosova od jednog roditelja državljanin Kosova, a drugi roditelj strani državljanin ili bez državljanstva</p>
--	--	---

